

FONDI SHOIPTAR I ZHVILLIMIT
FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data : 19.06.2017]

Për: Operatorin Ekonomik “Salillari” shpk

Procedura e prokurimit: **“Tender i Hapur”** me objekt : **“Ndertim Asfaltim i rruges Cerrik – Belsh – Dragot – Kucove – Ure Vajgurore”**.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Ndertim Asfaltim i rruges Cerrik – Belsh – Dragot – Kucove – Ure Vajgurore”**.

Kohëzgjatja: brënda 18 muajsh nga data e fillimit te punimeve.

Fondi limit: 1.041.230.892 (nje miliard dyzet e nje milion e dyqind e tridhete mije e teteqind e nentedhete e dy) Lekë pa TVSH. Fondi i akorduar per vitin 2017 eshte 208.246.178 lekë pa tvsh. Pjesa e mbetur është parashikuar për vitin 2018.

Burimi i financimit: Buxheti i Shtetit.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: **Datë 15.05.2017.**

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): Nuk ka patur.

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara pa tvsh:

NR	SHOQERIA	OFERTA PA TVSH PARA KONTROLLIT ARITMETIK
1	SALILLARI	689,987,164
2	EUROTEOREMA PEQIN	693,240,307
3	VELLEZERIT HYSA	699,231,251
4	ALBA KONSTRUKSION	706,384,920
5	CURRI	717,146,787
6	GPG COMPAMY	719,511,738
7	GENER 2	729,288,515
8	ALB - STAR	735,108,626
9	AGBES KONSTRUKSION	770,116,376
10	VICTORIA INVEST INTERNATIONAL	819,987,070
11	2T	867,268,459
12	GJIKURIA	895,448,068
13	GJOKA KONSTRUKSION	901,123,230
14	TIMOS KAREFYLLAKIS	1,009,291,788

Pas vleresimit te dokumentacionit te paraqitur komisioni me unanimitet vendosi:

1. Te skualifikoje bashkimin e Operatoreve Ekonomike “Euroteorema Pegin” shpk (51%) dhe “Albavia” shpk (49%) pasi:

Bashkimi i shoqerive nuk ploteson kerkesen 2.3.7 per kualifikim lidhur me disponimin e makinerive dhe paisjeve, pasi nuk disponon gjashte coper kamione vetëshkarkues me kapacitet mbajtes jo me pak se 20 ton . Referuar dokumentacionit te paraqitur rezulton se kamionet AA723LO dhe AA825LN nuk plotesojne kerkesen per tonazhin pasi kapaciteti mbajtes I tyre eshte perkatesisht 15,5 ton dhe 16 ton. Gjithashtu edhe kamioni me targe AA913HR nuk mund te merret ne konsiderate pasi nuk eshte shenuar ne formularin e deklarimit te mjeteve.

Duke qene se kjo e mete eshte thelbesore, komisioni vendosi te mos vazhdoje me vleresimin e dokumentacionit te mbetur.

2. Te skualifikoje bashkimin e Operatoreve Ekonomike “Vellezerit Hysa” shpk (61.6%), “Varaku E” shpk (25.4%) dhe “Ergi” shpk (13%) pasi:

Shoqeria “Ergi” shpk nuk ploteson kerkesen 2.2.4 per kualifikim lidhur me taksat vendore pasi nuk ka paguar taksat per vitin 2017 ne Tirane (Berzhite) ku ka kryer aktivitet nga data 12.04.2016 deri ne daten 16 mars 2017. Edhe deklarata e paraqitur per te plotesuar kerkesen 2.2.5 per kualifikim rezulton e pa vertete.

Shoqeria “Ergi” shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.5 per kualifikim lidhur me punesimin e mjekut pasi kontrata me mjekun eshte lidhur ne daten 01.02.2017 e, ne kete menyre, nuk figuron ne listepagesen e janarit, ne perputhje me kerkesen per kualifikim.

Duke qene se keto te meta jane thelbesore, komisioni vendosi te mos vazhdoje me vleresimin e dokumentacionit te mbetur.

3. Te skualifikoje bashkimin e Operatoreve Ekonomike “Alba Konstruksion” shpk (80%) dhe “PE VLA KU” shpk (20%) pasi:

Shoqeria “Alba Konstruksion” shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.3 per kualifikim lidhur me punesimin e inxhinierëve, pasi pjese nga stafi i deklaruar ne kete procedure eshte i angazhuar ne kontraten “Rikualifikim urban i Bashkise Puke”, per te cilen ky operator ekonomik eshte shpallur nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

Shoqeria “Alba Konstruksion” shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.4 per kualifikim lidhur me deklarimin per mosangazhimin e stafit, pasi deklarimi nuk eshte ne perputhje me kerkesen. Ne deklarate shoqeria nuk shprehet se “inxhinieret jane te pa angazhuar”, por “stafi nuk do te jete i angazhuar ne kontrata te tjera”, deklarate qe eshte e ndryshme nga kerkesa.

Duke qene se keto te meta jane thelbesore, komisioni vendosi te mos vazhdoje me vleresimin e dokumentacionit te mbetur.

4. Te skualifikoje bashkimin e Operatoreve Ekonomike “Curri” shpk (75%) dhe “Be-Is” shpk (25%) pasi:

Shoqeria “Curri” shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.3 per kualifikim lidhur me punesimin e inxhinierëve, pasi nuk ka paraqitur asnje dokument per punesimin e inxhinierëve te kerkuar. Te

gjithe inxhinieret e deklaruar ne deklaraten per stafin (paraqitur nga shoqeria “Curri” shpk) jane te punesuar nga shoqeria “Be-Is” shpk e cila ka marre persiper te kryeje vetem 25% te punimeve. Shoqeria “Curri” shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.7 per kualifikim lidhur me disponimin e mjeteve te nevojshme teknike per realizimin e kontrates, pasi ka marre persiper punime per te gjithe zerat e parashikuar ne preventivin e punimeve dhe, referuar formularit te deklarimit te mjeteve, nuk ka paraqitur dokumentacion per disponimin e nje greideri, gurëthyes frontoje, impiant automatik betoni, autobitumatriçe, mjet autovinç. Keto mjete jane te domosdoshem per realizimin e punimeve qe ka marre persiper.

Duke qene se keto te meta jane thelbesore, komisioni vendosi te mos vazhdoje me vleresimin e dokumentacionit te mbetur.

5. Te skualifikoje Operatorin Ekonomik “GPG” shpk pasi:

Shoqeria “GPG” shpk nuk ploteson kerkesen 2.2.4 per kualifikim lidhur me taksat vendore pasi nuk ka paraqitur vertetim per shlyerjen e detyrimeve vendore te vitit 2016 ne Korce, ku ushtron aktivitet qysh prej vitit 2016, referuar tabelës se deklarimit te puneve ne proces.

Duke qene se kjo e mete eshte thelbesore, komisioni vendosi te mos vazhdoje me vleresimin e dokumentacionit te mbetur.

6. Te skualifikoje “Gener 2” shpk pasi:

Nuk ploteson kerkesen 2.d te Kerkesave te Vecanta per kualifikim pasi Formulari i Vleresimit i paraqitur nuk eshte ne perputhje me Formularin 8 te miratuar ne DST, Formulari i paraqitur nuk permban vleren e objektit.

Nuk ploteson kerkesen 2.2.5 per kualifikim lidhur me deklaraten per taksat vendore pasi ne deklaraten e paraqitur nuk eshte shprehur sipas kerkeses se *“ka paguar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, ne vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet per vitet 2016 dhe 2017”*.

Nuk ploteson kerkesen 2.3.1 per kualifikim lidhur me punet e ngjashme pasi Formulari i Vleresimit i paraqitur nuk eshte ne perputhje me Formularin 8 te miratuar ne DST, Formulari i paraqitur nuk permban vleren e objektit.

Nuk ploteson kerkesen 2.3.4 per kualifikim lidhur me deklaraten per mosangazhimin e inxhinierëve, pasi ne deklaraten e paraqitur nuk shprehet sipas kerkeses *“inxhinieret e kerkuar ne piken 2.3.3 per kualifikim jane te pa angazhuar ne kontrata te tjera”*.

Duke qene se keto te meta jane thelbesore, komisioni vendosi te mos vazhdoje me vleresimin e dokumentacionit te mbetur.

7. Te skualifikoje bashkimin e Operatoreve Ekonomike “Agbes Konstruksion” shpk (91.58%) dhe “Kola Invest” (9.42%) pasi:

Shoqeria “Agbes Konstruksion” shpk nuk ploteson kerkesen 2.2.1 per kualifikim lidhur me xhiron e realizuar ne tre vitet e fundit pasi sipas perqindjes se puneve qe ka marre persiper duhet te kishte realizuar nje xhiro mesatare 953.559.251 leke, nderkohe qe ka realizuar 943.215.004 leke duke mos permbushur kushtin.

Shoqeria “Agbes Konstruksion” shpk nuk ploteson kerkesen 2.2.3 per kualifikim lidhur me gjendjen ne banke pasi sipas perqindjes se puneve qe ka marre persiper duhet te kishte 95.355.925 leke gjendje ne banke, nderkohe qe ka 95.030.011 leke duke mos permbushur kushtin.

Duke qene se keto te meta jane thelbesore, komisioni vendosi te mos vazhdoje me vleresimin e dokumentacionit te mbetur.

8. Te skualifikoje bashkimin e Operatoreve Ekonomike “Victoria Invest International” shpk (67.08%%) dhe “Victoria Invest” (9.42%) pasi:

Shoqeria “Victoria Invest International” shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.7 per kualifikim lidhur me disponimin e makinerive dhe paisjeve, pasi nuk ka paraqitur dokumentacion (referuar formularit te deklarimit te mjeteve) per disponimin e nje furce mekanike per pastrim dhe ten je kompresori, mjete te domosdoshem per realizimin e puneve qe ka marre persiper.

Duke qene se kjo e mete eshte thelbesore, komisioni vendosi te mos vazhdoje me vleresimin e dokumentacionit te mbetur.

9. Te skualifikoje bashkimin e Operatoreve Ekonomike “2T” shpk dhe “Alko Impex General Costrucion” pasi:

Nuk kane paraqitur marreveshjen e bashkepunimit ne perputhje me ligjin.

Duke qene se kjo e mete eshte thelbesore, komisioni vendosi te mos vazhdoje me vleresimin e dokumentacionit te mbetur.

10. Te skualifikoje bashkimin e Operatoreve Ekonomike “Gjiguria” shpk (75%) dhe “4A M” (25%) pasi:

Shoqeria “Gjiguria” shpk nuk ploteson kerkesen 2.2.3 per kualifikim lidhur me gjendjen ne banke, pasi sipas perqindjes se puneve qe ka marre persiper duhet te kishte paraqitur vertetim per disponimin e 78.092.919 lekeve, nderkohe qe ka paraqitur vertetim se disponon 57.757.039 leke, duke mos e plotesuar kete kusht.

Duke qene se kjo e mete eshte thelbesore, komisioni vendosi te mos vazhdoje me vleresimin e dokumentacionit te mbetur.

11. Te skualifikoje Operatorin Ekonomik “Timos Karefyllakis” pasi:

Ne sistemin elektronik te prokurimit, ne emer te operatorit ekonomik “Timos Karefyllakis” jane ngarkuar dokumenta te shoqerise greke “Aktor” sa. Duke qene se ka nje mosperputhje te emrit te operatorit ekonomik qe ka aplikuar ne sistemin elektronik te prokurimit (“Timos Karefyllakis”) me emrin e shoqerise per te cilen jane ngarkuar dokumentat (“Aktor” sa), komisioni gjykon se keto dokumente nuk mund te konsiderohen te vlefshme.

Duke qene se kjo e mete eshte thelbesore, komisioni vendosi te mos vazhdoje me vleresimin e dokumentacionit te mbetur.

12. Te skualifikoje Operatorin Ekonomik “Fled” shpk pasi:

Nuk ka paraqitur dokumentacion per kualifikim.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin ekonomik “Salillari” shpk se oferta e paraqitur, me vlerë **689,987,164 (gjashtëqind e tetëdhjete e nente milion e nentëqind e tetëdhjete e shtate mije e njëqind e gjashtëdhjete e kater)** lekë pa TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Autoritetit Kontraktor:**

- **Fondi Shqiptar i Zhvillimit**
- **Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 10, Tirana, Albania**

- **Phone: 00355 4 2 235 597/8 (int.151)**
- **Fax: 00355 4 2 234 885**

sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda pese ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **30.05.2017**.

Ne datën 05.06.2017 paraqiti ankese shoqëria "Victoria Invest International" shpk. Ankeses ju kthye pergjigje ne daten 05.06.2017 duke e refuzuar ate.

Ne datën 05.06.2017 paraqiti ankese shoqëria "Aktor" shpk. Ankeses ju kthye pergjigje ne daten 05.06.2017 duke e refuzuar ate.

